



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 396/2023

Rrezarta Shehu

në lidhje me zvarritjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, përkitazi me lëndën gjyqësore C.nr.1784/19.

Drejtuar:

Znj. Albina Shabani-Rama, kryetare
Gjykata Themelore në Prishtinë

Prishtinë, 3 maj 2024

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me nevojën e ndërmarjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen pa vonesa të mëtutjeshme të lëndës C.nr.1784/19.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të znj. Rrezarta Shehut (ankuesja) dhe mbështetet në faktet dhe në provat e prezantuara prej saj, si dhe në shkresat e lëndës të cilat i posedon Avokati i Popullit, lidhur me lëndën C.nr.1784/19.

Baza ligjore

3. Sipas nenit 135, para. 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
4. Po ashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 8, përcakton: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave.”*

Përmbledhja e fakteve

5. Më 29 maj 2019, ankuesja kishte parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë padi me propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke e paditur palën “NPS AS PROJECT” përkitazi me pretendimet për pasurim të pabazë dhe për mospërbushje të kontratës.
6. Më 26 korrik 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte nxjerrë Aktvendimin C.nr.1784/19, me të cilin e kishte refuzuar propozimin për masën e sigurimit.
7. Më 1 tetor 2019, Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga propozuesja e masës së sigurimit, kishte nxjerrë Aktvendimin A.C.nr.4825/19, me të cilin e kishte anuluar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e kishte kthyer çështjen për rivendosje. Me këtë rast, Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, kishte kërkuar nga propozuesja e masës së sigurimit që ta precizonte saktë kërkesën e saj me padi, ta rregullonte kërkesëpadinë dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit, si dhe ta përcaktonte vlerën e objektit të padisë.
8. Më 22 dhjetor 2019, duke vepruar sipas kërkesës së gjykatës, propozuesja e masës së sigurimit kishte bërë precizimin e padisë.
9. Më 13 mars 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte nxjerrë Aktvendimin C.nr.1784/19, me të cilin e kishte refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, me arsyetimin se nuk ishin përmbushur kushtet ligjore.
10. Më 16 shtator 2020, Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës së propozueses së masës së sigurimit, kishte nxjerrë Aktvendimin A.C.nr.3934/20, me të cilin e kishte prishur Aktvendimin C.nr.1784/19, i datës 13 mars 2020, dhe çështjen e kishte kthyer për rivendosje, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes, do të duhej ta justifikonte vlerësimin që kishte për kushtin e rrezikut, duke dhënë arsye specifike për mosekzistimin e rrezikut në këtë rast.

11. Më 1 mars 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte nxjerrë Aktvendimin C.nr.1784/19, me të cilin e kishte aprovuar pjesërisht propozimin për masën e sigurimit duke caktuar masën e sigurimit të kërkesës në të holla, si dhe e kishte refuzuar propozimin për ndalimin e tjetërsimit të banesës nga kundërshtarët e masës së sigurimit.
12. Më 23 maj 2023, Avokati i Popullit kishte pranuar ankesë nga znj. Rrezarta Shehu (ankuesja), e cila ishte ankuar kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë, me pretendimet për zvarritje të procedurës gjyqësore në lëndën C.nr.1784/19.
13. Më 18 korrik 2023, Avokati i Popullit i kishte dërguar shkresë Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe kishte kërkuar informata lidhur me veprimet e gjykatës për lëndën C.nr.1784/19.
14. Më 8 shtator 2023, kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë ka kthyer përgjigje dhe e ka njoftuar Avokatin e Popullit për veprimet e ndërmarra nga gjyqtari i rastit në lëndën C.nr.1784/19, përkatësisht ka njoftuar se gjykata ka ndërmarrë vetëm veprime procedurale lidhur me propozimin për masën e sigurimit, ndërsa për sa i përket procedimit dhe trajtimit të lëndës lidhur me zgjidhjen meritore të kërkesëpadisë, ajo ka njoftuar se aktualisht gjyqtari i ngarkuar me lëndën në fjalë është duke proceduar me lëndë që janë regjistruar në gjykatë para lëndës C.nr.1784/19, prandaj kjo lëndë duhet të presë të zgjidhet sipas radhës.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21 thekson: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, [...]”*
16. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përcaktohet me nenin 31 të Kushtetutës: *“Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
17. Po ashtu, mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut garantohet me nenin 54 të Kushtetutës, i cili përcakton:
“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”
18. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj), në nenin 6, paragrafi 1, garanton: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor.”*
19. Ligji nr. 06/L - 054 për Gjykatat, neni 7 [*Qasja në Gjykata*], paragrafët 2 dhe 5, përcakton:
“Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor:
Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.”

Vlerësimi i Avokatit të Popullit

20. Në rastin në fjalë, Avokati i Popullit vëren se periudha përkatëse për t'u shqyrtuar lënda e ankueses fillon prej 29 dhjetorit 2019, data kur në Gjykatën Themelore në Prishtinë ishte parashtruar padia me propozim për caktimin e masës së sigurisë.
21. Bazuar në ecurinë gjyqësore të lëndës C.nr.1784/19, vërehet se Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Gjykata e Apelit e kanë trajtuar çështjen e ankueses vetëm për sa i përket masës së sigurimit, ndërkaq për më tepër se katër vjet nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore në kuptim të shqyrtimit thelbësor të kësaj çështjeje, gjegjësisht në kuptim të zgjidhjes meritore të kërkesëpadisë.
22. Nga informatat që Avokati i Popullit i ka në dispozicion me rastin e trajtimit të këtij rasti, vërehet se ankuesja nuk ka kontribuar në çfarëdo zvarritje të procedurës gjyqësore. Prandaj Avokati i Popullit vlerëson se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së në kuptim të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.
23. Në anën tjetër, mungesa e mjeteve efektive lidhur me shkeljen e së drejtës për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshme, siç është i garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës, i cili përcakton: “Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.”
24. Për sa i përket zbatimit të nenit 13 të Konventës, Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë lidhur me palët kontestuese, të cilat nuk kanë mjete, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit vendor ligjor (shih aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë, më 28 korrik 1999*; dhe aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë, më 28 korrik 1999*).
25. Neni 13 i KEDNj-së pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht dhe në mënyrë primare t'i mbrojtë të drejtat e njeriut nëpërmjet sistemit të tij ligjor duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë për një individ për të siguruar që ai apo ajo gëzon të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrorë këtë ankesë të një autoritet vendor. Kërkesat e nenit 13 përkrahin ato të nenit 6 (aktgjykimi në rastin *Kudla kundër Polonisë, më 26 tetor 2000*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv te një autoritet vendor për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6 për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Pasi rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.
26. Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalonin shkeljen e pohuar ose ta parandalonin vazhdimin e saj, ose për të ofruar përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që kishte ndodhur (shih aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*).
27. Avokati i Popullit konstaton se e drejta për proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm si dhe e drejta për mjete efektive juridike nuk janë përmbushur në çështjen e

ankueses, prandaj me këtë rast ka pasur shkelje të së drejtës së garantuar me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj.

28. Zvarritjet e procedurës gjyqësore shkaktojnë pasoja serioze në sundimin e ligjit dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Zvarritja e rastit gjyqësor në fjalë, e cila sipas praktikës së GjEDNj-së fillon të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë, që në rastin konkret është data 4 maj 2017, pa vendim përfundimtar, shkel:

- *të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuar dhe të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së;*
- *të drejtën për mjete efektive juridike të mbrojtura me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të KEDNj-së;*
- *të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*

29. Duke u bazuar në të lartcekurat, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”; dhe me nenin 16, paragrafi 8, të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit: “Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurës.”; bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke u referuar në argumentet e lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës, i

REKOMANDON

Gjykatës Themelore në Prishtinë:

- ***Pa vonesa të mëtutjeshme, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtim dhe vendosje e lëndës C.nr.1784/19.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/l-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naïm Qelaj
Avokat i Popullit